

LIGJ
Nr.7593, datë 29.7.1992

**PËR NJË RIFORMULIM TË NENIT 80 TË LIGJIT NR.7573, DATË 16.6.1992 "PËR
ZGJEDHJET E ORGANEVE TË PUSHTETIT LOKAL"**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 43 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese" me propozim të Grupit Parlamentar të Partisë Socialdemokrate,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Në ligjin nr.7573, datë.16.6.1992 "Për zgjedhjet e organeve të pushtetit lokal", neni 80 të riformulohet në këtë mënyrë:

"Numri i vendeve që i takojnë çdo subjekti elektorale caktohet në proporcion me numrin e votave të vlefshme që ka fituar çdo subjekt. Shpërndarja bëhet duke i dhënë çdo subjekti një numër të plotë vendesh nëpërmjet rrumbullakosjes nga lart sipas radhës (duke u nisur nga shifra më e lartë pas presjes dhjetore).

Vendet e fituara u jepen kandidatëve në bazë të renditjes që kanë në listat e paraqitura nga subjektet elektorale".

Neni 2

Paragrafi i dytë i nenit 1 të dekretit nr.267, datë 22.7.1992 "Për një shtesë në ligjin nr.7573, dt.16.6.1992 "Për zgjedhjet e organeve të pushtetit lokal" së bashku me formulën përkatëse, shfuqizohet.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekretin nr.272, datë 30.7.1992 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha.